



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

LEGJISLATURA VII

Sesioni pranveror

Komisioni për Çështje të Sigurisë dhe Mbrojtjes

Mbledhja nr.9

Prishtinë, më 12.08. 2020, në orën 10:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla N-10

PROCESVERBAL

I MBLEDHJES SË KOMISIONIT PËR ÇËSHTJE TË SIGURISË DHE MBROJTJES

Në mbledhje morën pjesë: Fatmire Kollçaku, kryetare e Komisionit, Bekë Berisha, nënkryetar i parë, Slavko Simiq, Nënkyetar i dytë, Rexhep Selimi, Mefail Bajqinovci, Ilir Tasholli, Hetem Baxhaku, Elmi Reçica, Ganimete Musliu, Rasim Demiri, anëtarë.

Mungoi: Haxhi Shala, Slavko Simiq.

Nga stafi mbështetës i komisionit: Nur Çeku dhe Zarë Aliu.

Mbledhjen e kryesoi, Fatmire Kollçaku, kryetare e Komisionit

Në këtë mbledhje u propozua ky

Rend i ditës:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Diskutim lidhur me situatën e Sigurisë në Republikën e Kosovës;
3. Shqyrtimi dhe miratimi i raportit për përzgjedhjen e Komisionerit të Agjencisë për Informim dhe Privatësi;
4. Të ndryshme.

Kryetari i komisionit konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës dhe e hapi mbledhjen.

1. Miratimi i rendit të ditës.

Rendi i ditës u miratua pa ndryshime.

2. Diskutim lidhur me situatën e Sigurisë në Republikën e Kosovës.

Kryetarja, fillimisht theksoi se ishte paraparë që të raportoj Ministri i Punëve të Brendshme si dhe Drejtori i Përgjithshëm i Policisë, por pas një sërë emailësh nuk kanë pranuar që të raportojnë në Komision, lidhur me shfaqjen e xhandarmërisë serbe në fshatin Karaçevë.

Bekë Berisha, theksoi se çështjet e sigurisë na preukopojnë të gjithëve, ndërsa sa i përket xhandarmërisë serbe që ka hyrë në territorin e Kosovës, e konsideroi si shqetësim, gjithashtu në muajin mars, xhandarmëria ka hyrë në territorin e Kosovës. Nga Qeveria e kaluar nuk ka pasur asnjë reagim, ndërsa nga Drejtori i Policisë është thënë që Policia e Kosovës nuk ka të drejtë të hyj në atë pjesë. Ndërsa këtë herë nuk mund ta kaloj duke thënë që, nuk ka pas fakte, pasi Drejtori i policisë nuk është për të përfutur nga tenderët apo çështje të tjera, por për të kryer detyren e përcaktuar me ligj, nëse nuk e kryen duhet të jap përgjegjësi.

Rexhep Selimi, sa i përket çështjes së ngritur nga z.Berisha, theksoi se nuk mund ta adresojmë tek qeveritë e djeshme apo pardjeshme, por qasjen ndaj këtij problemi, ndërsa sa i përket hyrjes së ushtrisë serbe, jo xhandarmëria është shqetësim i madh. Nga banoret e fshatit Karaçevë, ka shqetësime dhe e kanë shprehur çdo herë, por asnjëherë nga qeveritë e mëhershme nuk është trajtuar si duhet. Ndërsa sa i përket hyrjes së forcave serbe, ka vazhduar nga ana e tyre që të hyjnë në territorin e Kosovës. Deri tani institucionet e Kosovës nuk kanë ndërhyrë për të adresuar shqetësimet e qytetarëve.

Bekë Berisha, shtoi se incidente të tilla si në Karaçevë, duhet të identifikohen nga AKI-ja dhe nga Policia kufitare, pasi nuk është në rregull të fshihen institucionet e Kosovës.

Mefail Bajqinovci, theksoi se pasi ka pranuar videon nga pronari i restorantit, që shihet ushtria serbe duke defiluar, ka realizuar një vizitë në fshatin Karaçevë. Tutje theksoi se në këtë pjesë ka kazino dhe aktivitete të tjera, ndërsa është hera e parë që ushtria serbe e uniformuar që kanë dalë në rrugën e asfaltuar. Ndërsa s ai përket nëse ka qenë patrullim i përbashkët me KFOR-in, atëherë si është e mundur që pesëqind metra brenda territorit të Kosovës, të hyjnë ushtria serbe. Nga qytetarët është thënë, që nuk do të rrinë duar kryq nëse do të ketë prapë hyrje të ushtrisë serbe, propozoi që të ftohen në raportim në komision, Ministri i punëve të Brendshme, Drejtori i Policisë si dhe Ministri i Mbrojtjes.

Elmi Reçica, theksoi se jo vetëm për rastin e Karaçevës, por janë dimensione të shumta që duhet diskutuar në fushën e sigurisë, siç është pandemia dhe të tjera. Tutje theksoi se Komisioni duhet të ketë informacion të saktë, sa i përket patrullimeve të përbashkëta mes KFOR-it dhe xhandarmërisë serbe. KFOR-i, vepron sipas Rezolutës 1244, ndërsa është fatkeqësi që akoma nuk kemi demarkacion me Serbinë. Propozoi që të realizohet një vizitë pune në Karaçevë si dhe të ftohen ministrinë kompetente, për të dhënë informacione të sakta, më pastaj të kërkojmë

përgjegjësi, pasi është shqetësuese nëse qytetarët duan të reagojnë. Është dështim i shtetit nëse arrijmë në këtë gjendje.

Bekë Berisha, përkrahu idenë për të realizuar vizitën në Karaçevë dhe propozoi që Ministri i Punëve të Brendshme dhe Ministri i Mbrojtjes të ftohen në interpelancë.

Ilir Tasholli, e konsideroi shqetësuese situatën, ndërsa informacionet e dhëna nga z.Bajqinovci e konsideroi tejet problematike, pasi janë njëzet vite që ata qytetar të jetojnë në tension. Komisioni duhet të shoh nga afër situatën dhe përkrahu idenë për të realizuar një vizitë në Karaçevë në mënyrë që ti jepet zgjidhje një herë e mirë kësaj çështje.

Ganimete Musliu, lidhur me ngjarjen e ndodhur në Karaçevë, theksoi se ka marrë mesazhe dhe video nga qytetarët, por kjo çështje nuk zgjidhet nëse shkojmë individualisht atje. Komisioni duhet të kërkoj raport me shkrim nga organet e sigurisë. Ndërsa nuk pajtohet me deklaratën e ministrit të Punëve të Brendshme, i cili e ka cilësuar si një vizitë rutinë e sinkronizuar me KFOR-in. Tutje theksoi se pajtohet që të ftohet në interpelancë Ministri i Punëve të Brendshme, ndërsa e konsideroi të nevojshme që të kenë informacion edhe nga KFOR-i për këto patrullime dhe përgëzoi qytetarin që ka shpërndarë videon.

Rasim Demiri, lidhur me rastin në Karaçevë, shtoi se pikërisht në ditën kur në kuvendin e Kosovës është diskutuar për projektligjin vlerat e UÇK-së, atë ditë ndodhi që ushtria serbe të defiloj në territorin e Kosovës. A ka qenë rastësi apo jo kjo? Rasti në Karaçevë është për çdo dënim, institucionet e Kosovës nuk kanë reaguar sa duhet. Komisioni nuk ka informacione lidhur me këtë çështje, Kuvendi është dashur të thërras seancë të jashtëzakonshme, pasi nëse një gjë e tillë do të ndodhte në Serbi, kjo çështje do të shkonte në Këshill të Sigurimit.

Rexhep Selimi, konsideroi që Komisioni është duke e kryer punën si duhet, ndërsa nuk e konsideroi në rregull që të përmendet demarkacioni me Serbinë, përderisa Karaçeja është një fshat i Kosovës, kontrolli i kufirit është nën menaxhimin e KFOR-it. Ajo çfarë është parë, nuk ka qenë patrullim i përbashkët me KFOR-in e as i sinkronizuar, prandaj do ishte mirë që ti drejtohem Komandantit të KFOR-it për këtë çështje dhe më pas të vazhdohet me interpelancën në Kuvend.

Elmi Reçica, e konsideroi të nevojshme raportimin në Komision të Ministrit të Punëve të Brendshme, ministrit të Mbrojtjes si dhe Drejtorin e Përgjithshëm të Policisë, gjithashtu nëse do ishte e mundur edhe një përfaqësues i KFOR-it. Gjithashtu shtoi se reagimet nga institucionet e sigurisë nuk kanë qenë të duhura.

Ilir Tasholli, e konsideroi të nevojshme raportimin nga ministrat e linjës dhe drejtorin e Policisë, duke qenë se Komandanti i FSK-së do të raportoj nesër.

Kryetarja, lidhur me raportimet e ministrave, shtoi se për Ministrin e Punëve të Brendshme, konsideroi që interpelanca do të ishte më e drejtë, për shkak se i janë dërguar disa ftesa dhe nuk ka ardhur, ndërsa si Kryetare nga grupi parlamentar mund ta inicioj interpelancën. Ministri i Mbrojtjes ka shprehur gatishmërinë për të raportuar gjithëherë. Sa i përket vizitës në Karaçevë, theksoi se duhet parë mundësia, për shkak se situata me pandeminë si dhe rrethanat e tjera mund

të ndikojnë. Ndërsa sa i përket informacionit nga KFOR-i, e konsideroi të nevojshme të kërkohet ndonjë raport apo takim me ta lidhur me rastin në Karaçevë.

Elmi Reçica, konsideroi që fillimisht të ftohen Ministri i Punëve të Brendshme, Drejtori i Policisë, Ministri i Punëve të Brendshme dhe Komandantin e FSK-së. Ndërsa sa i përket informacionit nga KFOR-i, propozoi që të bëhen konsultimet me stafin dhe të kërkohet raport nga ana e tyre nëse është e mundur.

Hatim Baxhaku, theksoi se para se të kemi interpelancën me ministrat, të ftohen në Komision që të japin informacionet e nevojshme, ndërsa vizitën në Karaçevë e mbështet.

Elmi Reçica, propozoi që të premtën të realizohet vizita në Karaçevë, gjatë pauzës së seancës.

Rexhep Selimi, lidhur me vizitën në Karaçevë, theksoi se duke qenë se është koha e shkurtër duket e pa mundur. Ndërsa sa i përket interpelancës për Ministrin e Punëve të Brendshme, theksoi se kjo mund të bëhet nga deputetët e Komisionit.

Mefail Bajqinovci, theksoi se e mbështet propozimin për interpelancë të Ministrit të Punëve të Brendshme, duke qenë se nuk ka shprehur gatishmërinë të vijë në Komision. Gjithashtu e konsideroi të nevojshme realizimin e vizitës në Karaçevë, për të parë se si Policia e Kosovës e ka kufirin 2-3 klm brenda.

Kryetarja, shtoi se do të shikohet mundësia për të kërkuar raport nga KFOR-i, ndërsa sa i përket vizitës në Karaçevë, nuk pati gatishmëri nga të gjithë për shkak të kohës shumë të shkurtër, por mund të diskutohet prapë në mbledhjen e Komisionit.

3. Shqyrtimi dhe miratimi i raportit për përzgjedhjen e Komisionerit të Agjencisë për Informim dhe Privatësi;

Kryetarja, fillimisht theksoi që Komisioni ka autorizuar panelin, i cili ka punuar për përzgjedhjen dhe intervistimin e kandidatëve për pozitën e Komisionerit të Agjencisë për Informim dhe Privatësi. Procesi është mbështetur edhe nga Projekti i BDO përmes Memorandumit të nënshkruar nga Kuvendi i Kosovës dhe Ambasada Britaneze në Prishtinë. Përzgjedhja e Komisionerit është shumë e rëndësishme për shkak se janë fondet e IPA-s të cilat janë ndarë, por pa përzgjedhjen e Komisionerit nuk mund të alokohen. Nga projekti britanez janë bërë vlerësimet për kandidatët gjithashtu.

Sipas raportit vlerësues të panelit përzgjedhës, lista e kandidatëve është si në vijim: 1.Bujar Sadiku 36.4 pikë 2.Krenare Sogojeva-Dërmaku 33.4 pikë dhe 3.Muharrem Mustafa me 32.8 pikë. Kandidatë e përmendur i nënshtrohen votimit në Kuvend dhe kandidati që merr shumicën e votave të të gjithë deputetëve, zgjidhet Komisioner i Agjencisë për Informim dhe Privatësi.

Komisioni për çështje të Sigurisë dhe Mbrojtjes në këtë pikë të rendit të ditës me vota unanime nxori këtë:

REKOMANDIM

Lista e kandidatëve që kanë kaluar fazën e intervistimit dhe që procedohet për seancë është: 1.Bujar Sadiku 36.4 pikë 2.Krenare Sogojeva-Dermaku 33.4 pikë dhe 3.Muharrem Mustafa me 32.8 pikë. Kandidatë e përmednur i nënshtrohen votimit në Kuvend dhe kandidati që merr shumicën e votave të të gjithë deputetëve, zgjidhet Komisioner i Agjencisë për Informim dhe Privatësi.

4. Të ndryshme

Kryetarja, njoftoi që GIZ-i gjerman ka shprehur gatishmërinë për të mbështetur Komisionin me një ekspert në funksion të përmirësimit të legjislacionit, sa i përket kapitullit 24. Propozoj që si Komision të aprovojme këtë kërkesë dhe më pas të caktohen temat.

Komisioni për çështje të Sigurisë dhe Mbrojtjes me vota unanime pajtohet që të mbështeten me ekspertin nga GIZ, ku do të ketë dakordim të përbashkët nga lista e ekspertëve dhe temat.

Me këtë pikë të rendit të ditës e konsideroi mbledhjen e mbyllur.

Mbledhja përfundoi në orën 10:15.

E përgatiti:

Stafi mbështetës i komisionit

Kryetare e komisionit,

Fatmire Kollçaku